




KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS  
KOSOVO MANUFACTURING CLUB

# RAPORT I PUNËS



- Avokim për përmirësim të politikave
- Bashkëpunim në mes të prodhuesve vendor & grupeve të interesit
- Vetëdijësim dhe promovim i produkteve “Made in Kosova”



## PËRMBAJTJA

Rreth nesh	4
Hyrje	5
4E	6
Anëtarët	7
Angazhim për të avancuar zhvillimin e sektorit të prodhimit	8
Fuqia e Klubit të Prodhuesve të Kosovës	8
Fokusi digjital	9
Projektet	10
Green Business Expo   Edicioni i 5-të	10
Platforma "Made in Kosova"	12
MEPPS	13
Aktivitetet	14
Iniciativat	19
Takimet	21
Anëtarët e Nderit në Klubin e Prodhuesve të Kosovës	30
Mirënjohjet	31
Ekipi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës	32



## RRETH NESH

Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) është organizatë biznesore e themeluar në Nëntor të vitit 2015 me qëllim që të avokoj për ndryshime në politika duke përfaqësuar prodhuesit vendor, të rrisë bashkëpunimin mes prodhuesve vendor dhe aktereve relevant si dhe të ngrit vetëdijen e qytetarëve për rëndësinë e konsumit të prodhimeve vendore dhe të promovoj produktet “Made in Kosova”.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës është zëri i prodhimit, të gjitha aktivitetet dhe programet që ndërmarrim kanë të bëjnë me krijimin e mundësive për të zhvilluar sektorin e prodhimit, fuqizojmë atë dhe që të rrisë konkurrueshmërinë e kompanive prodhuese.

## MISIONI

Ne stimulojmë suksesin për kompanitë prodhuese, duke i ndihmuar ata të përmbushin objektivat dhe qëllimet e tyre. Kështu fuqizojmë sektorët e ndryshëm prodhues dhe frymëzojmë gjeneratat e ardhshme. Ne u mundësojmë prodhuesve të rrjetëzohen, të ndajnë, të zgjidhin problemet dhe të krijojnë mundësi të reja së bashku.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës mbështet prodhimin për të krijuar një të ardhme digjitale, globale dhe të gjelbër. Angazhimi jonë fokusohet që të sigurojmë që kompanitë prodhuese të kenë udhëheqje të fortë, procese solide, aftësi teknike dhe aftësi konkurruese.

Në kuadër të programeve dhe aktiviteteve të tij, fokusi i Klubit do të jetë në tri objektivat në vijim:

# Hyrje

Të nderuar,

Është përsëri koha e fundit të vitit kur hedhim një vështrim prapa, duke synuar të shohim se çfarë kemi bërë, çfarë mund të bënim më mirë dhe prej andej, ku duam të shkojmë. Viti i kaluar ishte edhe një vit i vështirë jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë botën, dhe kushdo që bënte biznes u përball në një mënyrë ose në një tjetër nga sfida të shumta.

Pandemia e COVID 19 e cila kaploi botën, dëmtoi bizneset e shumta, një gjendje e cila po i shtynë ekonominë drejt recesionit ekonomik, e një situatë e tillë nuk po e kursen as vendin tonë.

Viti 2020 ishte me të vërtetë një vit i vështirë, mirëpo Klubi i Prodhuesve ishte i përgatitur dhe u bëri ballë këtyre vështirësive dhe u mobilizua për një kohë të shkurtër që edhe përkundër disancimit social, të ju gjendet afër prodhuesve dhe të ju përgjigjet kërkesave të tyre.

Ka qenë nderi dhe privilegji im të jem kryetari i Klubit të Prodhuesve përgjatë vitit 2020, një vit me shumë sfida e angazhime, por që me punën tonë kemi arritur të jemi të suksesshëm. Si kryetari i Klubit të Prodhuesve jam angazhuar maksimalisht që projektet dhe aktivitetet e Klubit të jenë në përputhje me vetë qëllimet dhe synimet tona.

Me punën e përbashkët të gjithë prodhuesve ne jemi munduar të ndihmojmë ekonominë e vendit tonë, të vazhdojmë prodhimin dhe të mbrojmë vendet e punës. Por para së gjithash, jemi munduar të ua lehtësojmë dhe përmirësojmë jetën qytetarëve tanë.

Të nderuar, në emër të Ekipit Ekzekutiv, dëshiroj ta tregoj se ishte një privilegj për t'ju shërbyer dhe për të qenë pjesë e përpjekjeve tuaja dhe të jem në krye të detyrës së bashku me ju. Unë ju premtoj se Klubi i Prodhuesve do të vazhdojë të punojë me shumë përpikëri dhe në të mirën e të gjithë prodhuesve, duke synuar të njëjtat objektiva – ndërtimin e një mjedisi më të mirë biznesi në Kosovë, duke krijuar vende të reja punës dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Ne jemi krenarë që jemi pjesë e një familje dhe ju falënderojmë për besimin dhe përkushtimin që të jenë pjesë e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Sinqerisht,

**Bashkim Osmani**

*Kryetar i Klubit të Prodhuesve të Kosovës*



Të nderuar anëtarë,

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor 2020, duke shënuar edhe një vit tjetër në misionin tonë për të promovuar një klimë më të mirë për sektorin e prodhimit në Kosovë. Viti 2020 do të jetë ndër vitet që do ta kujtojmë shumë gjatë, ku pandemia Covid-19 që ishte tema kryesore e këtij viti, e që kishte ndikim të ndryshëm në bizneset e vendit në varësi të industrisë.

Por, pavarësisht të gjitha vështirësive, në qendër të të gjithave vazhduat të jeni ju, anëtarët tanë, që përfaqësoni kompani udhëheqëse në pothuajse çdo sektor të ekonomisë. Fokusi i Klubi të Prodhuesve të Kosovës vazhdoj të jetë edhe përgjatë këtij viti në ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës që anëtarët tanë të kenë sukses dhe stabilitet.

Shtyllë kryesore e misionit tonë vazhdoi të jetë avokimi. Gjatë gjithë vitit 2020, Klubi i Prodhuesve vazhdoj të përfaqësojë interesat e anëtarëve dhe të avokojë në emrin tuaj me qeverinë, dhe shërbeu si platformë për dialog midis politikë bërësve dhe sektorit privat. Ishte Klubi, pjesë e grupit punues me qeverinë për pakon e rimëkëmbjes ekonomike, ku shumë prej rekomandimeve u morën në konsideratë si pjesë e ligjeve dhe rregulloreve të reja që mbështesin programin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit.

Mua më duhet të falënderoj edhe partnerët tanë të cilët përkrahen projektet tona, ku këtu vlen të përmendet fushata “Besa për Kosovën: Diaspora në ndihmë të atdheut gjatë pandemisë Covid-19”, fushatë kjo e organizuar në kushte të jashtëzakonshme, mirëpo shumë e suksesshme. Kjo fushatë ishte një përpjekje për të reaguar sa më parë dhe të ju vijmë në ndihmë familjeve në nevojë, por njëkohësisht ishte ndihmë edhe për ekonominë e Kosovës, ku u ndihmuan rreth 7200 qytetarë me produkte tërësisht Made in Kosova.

Po ashtu një sfidë tjetër të cilën e kemi tejkaluar me sukses ishte edhe ristrukturimi i organizatës sonë, ku koha tregoj që Klubit i duhej të rritej si organizatë dhe të përshtatej me strukturë dhe reformim që pjesë e tij të jenë edhe anëtarë të rinj.

Duke ju falënderuar të gjithë juve, dhe duke e ritheksuar që mbështetja dhe angazhimi juaj aktiv garanton suksesin e vazhdueshëm e kësaj organizate. Ndërsa ne ecim përpara, sigurohuni që Klubi i Prodhuesve po transformohet në mënyrë që të bëhet më tej një organizatë e fuqishme me në qendër prodhuesin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Duke ju uruar një vit edhe më të suksesshëm, ishte vërtet nder të shërbej si drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës !

Sinqerisht,

**Astrit Panxha**

*Drejtor Ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës*





## 4E ENVIRONMENT

### Ambienti

Klubi i Prodhuesve të Kosovës në kuadër të Strategjisë së Ambientit dëshiron të ndërtojë zhvillim të qëndrueshëm të sektorit ekonomik i cili respekton dhe kujdeset për ambientin. Suksesi i kësaj strategjie varet nga përpjekjet e kombinuara të grupeve të shumta të ruajtjes dhe qëndrueshmërisë në vend, bizneseve dhe organizatave të tjera qeveritare dhe joqeveritare. Synimi i Strategjisë është të mbështesë, të plotësojë dhe të nxisë këto përpjekje

## 4E ENERGY

### Energjia

Strategjia e Energjisë e KPK-së – adreson potencialet dhe sfidat që ka sektori i prodhimit sa i përket energjisë. Përmes kësaj strategjie synohet të bashkëpunohet me prodhuesit që të rrisin produktivitetin e tyre duke zbatuar masat e efikasitetit energjetik. Po ashtu, inkurajon prodhuesit që të përdorin energjinë e ripërtëritshme dhe eficiente si pjesë të zhvillimit të përgjithshëm të qëndrueshëm të vendit.

## (4E EMPLOYMENT

### Punësimi

Strategjia e Punësimit e Klubit të Prodhuesve të Kosovës synon që në koordinim me partnerët relevant të përmirësojë sistemin e arsimit e formimit profesional. Ku pjesë e rëndësishme e këtij sistemi do të jetë dhe ndërtimi i një partneriteti të qëndrueshëm me të gjithë akterët e tregut të punës. Kështu duke u fokusuar në krijimin e profesioneve të cilat janë të përshtatshme për tregun e punës dhe njëkohësisht duke kontribuar në zvogëlimin e hendekut të aftësisë profesionale në sektorin e prodhimit.

## 4E ECONOMIC DIPLOMACY

### Diplomacia ekonomike

Strategjia e Diplomacisë Ekonomike e Klubit Prodhues të Kosovës synon të nxisë rritjen e sektorit të prodhimit në vend. Kjo strategji synon, në bashkëpunim me palët e interesuara, të përdorin të gjitha lidhjet diplomatike për të përparuar prosperitetin e produkteve Made-in-Kosova jashtë tregjeve të vendit. Diplomacia ekonomike është një nga çelësat më të rëndësishëm për produktivitetet më të lartë dhe zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

## Anëtarët

Klubi ka gjithsej **21 anëtarë**, të cilët posedojnë **45 fabrika**, dhe janë akterë kyç në punësimin e të rinjve duke punësuar kështu më shumë se **15 mijë punëtorë** direkt dhe indirekt në të gjithë vendin.

Anëtarët e Klubit vijnë nga sektorë të ndryshëm të prodhimit në Kosovë siç janë: sektori i ushqimit, ndërtimit, përpunimit të metalit, përpunimit të drurit, riciklimit dhe paketimit. Ata kanë zhvilluar deri më tash më shumë se **100 brende** dhe janë në zhvillim të produkteve dhe brendeve të reja.

## Fuqia e Klubit të Prodhuesve të Kosovës

21

Anëtarë

15k

Të punësuar direkt dhe indirekt nga anëtarët e Klubit të Prodhuesve të Kosovës

45

Fabrika në pronësi të anëtarëve të Klubit të Prodhuesve të Kosovës

100

Brende dhe produkte

# Angazhim për të avancuar zhvillimin e sektorit të prodhimit

KPK përgjatë vitit 2020 ka punuar në vazhdimësi për të avancuar zhvillimin e sektorit të prodhimit në Kosovë.

## Fuqia e të qenurit aktiv

- Mbi 100 **kontakte** të zyrtarëve të **nivelet të lartë**
- Janë zhvilluar **6 takime virtuale** me insitucionet ndërkombëtare dhe bashkëpunëtorë
- **50 lidhje** të reja
- Janë nënshkruar **3 memorandume bashkëpunimi** me institucione dhe bashkëpunëtorë
- 10+ ngjarje të **suksesshme**
- 5000+ pjesëmarrës të **kënaqur**
- **4 propozime** për politika ekonomike
- Janë analizuar dhe komentuar një sërë **projekt-aktesh ligjore dhe vendime qeveritare**
- Janë hartuar **10+ kërkesa** për Institucione shtetërore
- 3 **nisma** të lansuara
- Mbi **200 takime** të zhvilluara
- 50+ **komunikata**, të cilat janë ndarë me mediat vendore
- Mbi 170 **shpërndarje** të komunikatave
- 53 **paraqitje** mediale ku Klubi është prezantuar
- **Monitorimi i Mediave**, 100+ përmbledhje me ngjarjet në ekonominë vendore
- **150,000+** Email-a të shkëmbyera
- **1,500+** Përmendje mediale



## Fokusi digjital

Fokusi i KPK-së ka qenë dhe do të vazhdoj të jetë përcjellja e mesazhit të duhur në kohën dhe vendin e duhur. Kjo është arsyeja pse ne, Klubi përdorim të gjitha mjetet dhe rrjetet për t'i mbajtur ndjekësit dhe të gjithë akterët tjerë të informuar/përditësuar.



### Klubi i Prodhuesve në @WWW [www.klubiprodhuesve.org](http://www.klubiprodhuesve.org)

50,258+ njerëz e kanë vizituar webfaqen e Klubit të Prodhuesve  
13,221+ prej tyre kanë qenë përdorues të rinj. 88.5% kanë qenë vizitorë të rinj dhe 11.5% kanë qenë vizitorë që janë rikthyer ta vizitojnë faqen.



### Klubi i Prodhuesve në @Twitter [@KlubiProdhuesve](https://twitter.com/KlubiProdhuesve)

Më shumë se 250 tweets kanë arritur 230 ndjekësit tanë ku kemi pasur 536 vizita të reja. Tweets e Klubit kanë fituar mbi 36,671 përshtypje përgjatë vitit 2020, që mesatarisht ka pasur rreth 100 përshtypje në ditë.



### Klubi i Prodhuesve në @YouTube [@KlubiProdhuesvetëKosovës](https://www.youtube.com/@KlubiProdhuesvetëKosovës)

Videot e KPK-së kanë pasur 7,300 përshtypje/impressions me 708 shikime. Videot e ndara në kanal in e YouTube janë video nga aktivitetet dhe programet e Klubit të zhvilluara gjatë vitit.



### Klubi i Prodhuesve të Kosovës në @Facebook [@klubiprodhuesve.org](https://www.facebook.com/klubiprodhuesve.org)

Prej Janarit 2020, faqja në Facebook e KPK-së ka pasur një rritje të qëndrueshme të ndjekësve nga 3440 pëlqime në faqe në 6,535 pëlqime, duke arritur 465,984 përdorues në Facebook



### Klubi i Prodhuesve të Kosovës @e-mail [info@klubiprodhuesve.org](mailto:info@klubiprodhuesve.org)

Përgjatë, vitit 2020 KPK ka dërguar mbi 34 email/kampanja përmes platformës MailChimp, për informim rreth aktiviteteve dhe projekteve të Klubit. Po ashtu, gjatë këtij viti është bërë edhe buletini i Klubit të Prodhuesve në baza mujore, të cilin e dërgojmë në formë të E-Lajmeve nga Klubi.



### Klubi i Prodhuesve të Kosovës në @LinkedIn [@kosovomanufacturingclub](https://www.linkedin.com/company/kosovomanufacturingclub)

Më shumë se 1,459 kontakte në llogarinë e KPK-së në LinkedIn, me mbi 5000 shikime të profilit.

## Projektet

Aktivitetet kryesore të KPK-së fokusohen rreth strategjisë kryesore të Klubit e emëruar 4E (Energy, Economic Diplomacy Employment, Environment), e cila përfshinë Energjinë, Diplomacinë ekonomike, Punësimin dhe Ambientin. Të gjitha projektet e KPK-së edhe këtë vit janë zhvilluar në bazë të kësaj strategjie. Gjatë vitit 2019 janë realizuar këto **5 projekte**, ndërsa 1 projekt i fundit i listuar në vijim është në fazën fillestare të implementimit:

- **Green Business Expo, edicioni i pestë; Platforma "Made in Kosova";**
- **Platforma "Made in Kosova";**
- **MEPPS – Skema e Planifikimit dhe Promovimit të Eksportit për Prodhuesit (Manufacturing Export Promotion Plan Scheme);**

## Green Business Expo | Edicioni i 5-të







Green Business Expo (i njohur më parë si Festivali i Gjelbër) është i **vetmi panair** në Kosovë, që si synim kryesor ka promovimin e biznesit të gjelbër. Ky ishte viti i pestë që u organizua dhe ku kompanitë e sektorit të gjelbër u mbledhën për të ndarë praktikën e qëndrueshme mjedisore që korrespondojnë me qëllimet globale për **një ambient sa më ekologjik**. Panairi synon të promovojë bizneset e gjelbra (përfshirë edhe sektorin e ndërtimit dhe eko-entrierit) në Kosovë, gjenerim të vendeve të punës të vazhdueshëm, të nxisë përmirësimet e nevojshme ligjore për mjedisin e biznesit të gjelbër dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet e adoptimit të praktikave/ teknologjive të gjelbra.

Këtë vit, për arsye të situatës me COVID-19, u vendos që ngjarja të vij me një **koncept inovativ** dhe të mbahet në **formë virtuale** [businessexpo.greenkosovo.com](https://businessexpo.greenkosovo.com) (e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze) me datë 1-2 Dhjetor, 2020. Si rezultat, duke përdorur resurset vendore, për herë të parë u zhvillua një platformë e tillë në Kosovë. Kjo platformë erdhi si nevojë por edhe dëshirë që t'i zhvillojmë si prodhimet por edhe shërbimet vendore, duke i promovuar produktet "Made in Kosova".

Aktivitetet kryesore ishin **Pavijoni i Gjelbër dhe Forumet e Gjelbra**. Suksesin e arritur, do të i'a lejojmë të dhënave të mëposhtme ta tregojnë:

- **24 kompani pjesëmarrëse vendore dhe ndërkombëtare** ([shkarko katalogun](#))
- **1,000 vizitorë virtual +** (nga vende të ndryshme të botës – Kosova, Gjermania, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Austria, Holanda, Franca dhe Serbia)
- **6 forume të diskutimeve**
- **12+ medime mbuluan ngjarjen**



## Platforma "Made in Kosova"


Platforma "Made in Kosova" është platforma e vetme në Kosovë, e cila do të prezantoj të gjitha kompanitë prodhuese të Kosovës. Qëllimi kryesor i Platformës është **digjitalizimi i bizneseve prodhuese të Kosovës** me qëllim të **promovimit të produkteve kosovare në mbarë botën**. Platforma është një panair i përhershëm online, ku secila kompani ka profilin e vet të kompanisë si dhe prezantohen produktet e saj. Platforma "Made in Kosova" do të vendosë produktet tona në hartën e produkteve të botës, do të i'u shërbejë rritjes dhe zhvillimit të kompanive kosovare, veçanërisht kompanive të vogla dhe të mesme, do të rris punësimin në Kosovë dhe do të i'u mundësojë kompanive të mëdha të bëhen pjesë e zinxhirit të vlerave globale.

Aktualisht, në platformë janë të prezantuara kompanitë më të mëdha eksportuese kosovare. Platforma synon të prezantoj rreth 3,000 kompani me rreth 30,000 produkte dhe në vazhdimësi është duke u zhvilluar tutje për të qenë në hap dhe në nivel me platformat e ngjashme botërore. Platforma tanimë është lider në Kosovë sa i përket prezantimit online të kompanive prodhuese dhe produkteve kosovare dhe brenda këtij viti ka arritur të ketë:

- Mbi **267,350** vizitorë (aktualisht);
- Dhjetëra kërkesa për **eksport** të produkteve kosovare;
- Interesim për krijim të **ndërmarrjeve bashkëpunuese** në mes të blerësve të huaj dhe kompanive kosovare

Për t'u informuar më tepër rreth platformës, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://www.facebook.com/klubiprodhuesve.org/videos/2563416423981034/?t=0>



## MEPPS

### SKEMA E PLANIFIKIMIT DHE PROMOVIMIT TË EKSPORTIT PËR PRODHUESIT MEPPS (MANUFACTURING EXPORT PROMOTION PLAN SCHEME)

KPK në bashkëpunim me partnerëtka ndërtuar një ekip që është i **specializuar në tregtinë ndërkombëtare** (këshillim dhe shitje) që ka ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë për kompanitë që të **eksportojnë**. Ky ekip është përgjegjës për të punuar në tregjet si Amerika e Veriut dhe Bashkimi Europian (BE), rajoni i CEFTA-s përfshirë Turqinë dhe Lindjen e Mesme me Afrikën e Veriut.

KPK me platformën **“Made in Kosova”** dhe me rrjetin e tij të gjerë ndërkombëtar mund të luajë një rol të rëndësishëm në **mbështetjen e eksporteve** të Kosovës, duke promovuar kushtet në të cilat eksportet mund të rriten dhe ndihmojnë kompanitë për të identifikuar dhe ndjekin mundësi të reja.

Këtë vit, projekti MEPPS ka arritur që me sukses të:

- Ofrim të shërbimeve të eksportit me **kosto minimale** në gjetjen e **kontakteve të biznesit**. **Shërbimet e Eksportit** përfshijnë (shiko këtu listën e shërbimeve të eksportit) ..\..\EXPORT materialet\Oferta e shërbimeve të eksportit.docx:
  - a) Faza para-eksportuese mbi gatishmërinë e kapaciteteve të kompanive;
  - b) Faza eksportuese mbi gjetjen e tregjeve të reja të përshtatshme;
  - c) Shërbime shtesë specifike të eksportit.
- Ndhimoj **1 kompani** në të gjitha fazat e saja të eksporteve duke filluar që nga matja e gatishmërisë për të eksportuar, **këshillimeve** për ndryshime të brendshme në kompani dhe po ashtu, ka arritur t'i siguroj kompanisë **partner të jashtëm për shitje** të produkteve të kompanisë;
- **2 kompani**, përgjatë vitit 2019 kanë marrë **konsulencë** në lidhje me **shërbime të eksportit**. Dy kompani kanë përfunduar fazën e parë dhe njëra do të kalojë në fazën e dytë në fillim të vitit 2020;
- **3 kompani** të cilat janë përzgjedhur që të ndihmohen (në fazat fillestare të eksportit ose ato të cilat tashmë eksportojnë), në **zgjerimin e tregjeve** të tyre nëpër vendet e tjera të BE-së, Amerikës, Afrikës dhe Lindjes së Mesme.



## Aktivitetet

### KONFERENCAT, TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA DHE PUNËTORITË

Gjatë vitit 2020 të zhvillimit të aktiviteteve të KPK-së, kanë qenë pjesë edhe organizimi i konferencave, tryezave dhe punëtorive për të trajtuar tema të rëndësishme për sektorin e prodhimit. Organizimi i aktiviteteve në formate të tilla ishte paraparë që të ndodhte në baza mujore, por këto aktivitete u ndërprejnë për shkak të pandemisë COVID19, dhe masave të distancimit social. Mirëpo rëndësia e këtyre aktiviteteve shihet posaçërisht në shkëmbimin e informatave për tema të caktuara dhe nxjerrjes së rekomandimeve të dobishme për ndryshimin e politikave dhe rregulloreve në fuqi – më qëllim mundësimin e mbarëvajtjes dhe zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në vend.

#### Konferenca: Tarifa prej 100% nuk është shtylla e zhvillimit ekonomik në Kosovë

Kjo tryezë e diskutimit e organizuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës pati për qëllim diskutimin mbi **efektet e tarifës doganore prej 100%** ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, në ekonominë e vendit tonë. Në fund të vitit të 2018 qeveria miratoi vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që fillimisht t'u vendoset masa prej 10% e pastaj prej 100% ndaj dy shteteve, Serbisë e Bosnjës dhe Hercegovinës, tarifë kjo e cila erdhi si kundërpërgjigje për agresivitetin e Serbisë ndaj Kosovës. Gjatë konferencës u paraqit një përmbledhje e raportit të të gjeturave të cilin mund ta shikoni [KËTU](#). Po ashtu u prezantua edhe **anketa e qytetarëve për konsumimin e prodhimeve vendore**.



## KONVENTA E PRODHUESVE TË KOSOVËS

Klubi i Prodhuesve të Kosovës mbajti edicionin e dytë të Konventës së Prodhuesve të Kosovës. Synimi kryesor i Konventës ishte diskutimi i hapur rreth temave të cilat ndikojnë në fuqizimin e prodhuesve dhe që rrisin konkurrueshmërinë e produkteve “Made in Kosova”. Edicioni i dytë i Konventës **u fokusua tregtinë rajonale, në digjitalizimin e sektorit të prodhimit dhe në tërheqjen e investimeve të huaja direkte**, si shtytës të zhvillimit ekonomik. Kjo konventë mbledhi shumë kompani prodhuese nga vendi dhe u përdor si një platformë për diskutim mbi bashkëpunimin ekonomik midis Kosovës dhe vendeve të rajonit.

Ky edicion u sponsorizua nga projekti për Promovimin e Punësimit në Sektorin Privat (PPSE), ProCredit Bank, Banka Botërore / Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), dhe u mbështet nga Forumi Ekonomik Mbarë-Shqiptarë. Partner këta që me punën e tyre në vazhdimësi kanë përkrahur sektorin e prodhimit në Kosovë.



## BESA PËR KOSOVËN: Diaspora në ndihmë të atdheut gjatë pandemisë Covid-19

### Takimi me Ambasadorin e Kosovës në Kroaci

Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Rrjeti i biznesit shqiptar në Bavari “Besa Foundation” si dhe organizata Germin, gjatë fillimit të pandemisë COVID 19, u bashkua për të filluar fushatën humanitare për familjet të cilat ishin në kushte të vështira ekonomike dhe në mbështetje prodhuesve vendorë.

Kjo fushatë ishte një përpjekje për të reaguar sa më parë dhe të ju vijmë në ndihmë familjeve në nevojë, por duke pasur parasysh që ekonomia e Kosovës ishte duke pësuar një krizë e cila do të mund të linte dëme të pariparueshme dhe afatgjata, e ku shumë bizneseve ju duhej ndihma jonë. Prandaj kjo fushatë ishte ndihmë edhe për ekonominë e Kosovës, pasi që 100% e fondeve të mbledhura për produktet baze të ushqimit dhe higjienës ishin MADE IN KOSOVA. Kjo për të ndihmuar fuqizimin e prodhimit në Kosovë që të marr vetën dhe të ju ofrojmë ndihmë familjeve në nevojë.

Nga kjo fushatë u ndihmuan 7 komuna me 1900 pako, ku 1900 familje apo diku rreth 7200 qytetar të cilët ishin në gjendje të rëndë financiare për shkak të pandemisë COVID-19, por edhe 220 punëtorëve në sektorin e prodhimit ju mundësua paga mujore. Komunat të cilat u ndihmuan gjatë kësaj fushate janë Vitia, Kamenica, Vushtrria, Podujeva, Gjakova, Podujeva, Skenderaj dhe në SOS Fshatrat e Fëmijëve.





## CERTIFIKIMI I GJENERATËS SË PARË NË PUNËTORINË “MADE IN KOSOVA”


KPK në bashkëpunim me fondacionin ERTEV është angazhuar që përmes punëtorisë “Made in Kosova” të ndihmoj fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik të cilët përkrahen nga programet e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë.

Me 24 Dhjetor, 2020 u **certifikua gjenerata e parë e punëtorisë “Made in Kosova”**. Qëllimi i kësaj punëtorie cilës është krijimi i një hapësire e cila mundëson **socializmin, ndërgjegjësimin dhe edukimin** e të rinjve për **orientimin në karrierë**, duke i mësuar ata mbi njohuritë bazike teknike, por edhe nxitjen e kreativitetit, mendimin inovativ dhe zgjidhjen e problemeve.

Punëtorija “Made in Kosova” përmban programe të cilat janë aktivitetet pas shkollore alternative për fëmijët dhe të rinjtë të moshës 8 deri 21 vjeç ku do të përfshihen:

- Klasa e drurit;
- Klasa metalike;
- Programim 3D dhe
- Klasa Origami.

Punëtorija gjendet në SOS Fshatrat e Fëmijëve në lagjen Velania, Prishtinë.



### MEMORANDUM MIRËKUPITIMI ME KOLEGJIN ARBËRI

Klubi i Prodhuesve nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Kolegjin Arbëri, për zhvillimin e një programi bashkëpunimi për shkëmbim akademik. Ky memorandum ka si qëllim vendosjen e raporteve të bashkëpunimit në drejtim të shkëmbimit akademik në mes të stafit, studentëve të kolegjit dhe Klubit të Prodhuesve. Ky synim do të arrihet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, promovuese si dhe shkëmbimit të rregullt të informacioneve reciproke për të gjitha fushat që kanë lidhje me veprimtarinë e dy institucioneve. Po ashtu, ky Memorandum ka për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapësirave që studentët e këtij kolegji të kenë mundësinë e kryerjes së praktikës në Klub si dhe pjesëmarrje të Klubit në programet e këtij kolegji.



### KLUBI I PRODHUESVE MEMORANDUM BASHKËPUNIMI RRJETIN EVROPIAN TË NDËRMARRJEVE

Klubi i Prodhuesve nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve, i përfaqësuar nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës – STIKK, për zhvillimin dhe implementimin e disa projekteve specifike përbrenda programit COSME. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim të mbështesë anëtarët e Klubit të Prodhuesve me shërbime profesionale individuale dhe këshilluese në lidhje me punën e Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve, por edhe ofrimin e shërbimeve tjera brenda platformës së tyre. Pjesë e këtij memorandumit të bashkëpunimi është edhe mbështetja dhe lehtësimi i anëtarëve të Klubit të Prodhuesve në aplikimin drejt thirrjeve të ndryshme të granteve të programit COSME dhe mundësive të tjera si ndërkombëtarizimi, inovacioni, promovimi i eksportit, teknologjia dhe transferimi i njohurive, etj.



# Iniciativat

Viti 2020 ishte vit i suksesshëm për Klubin e Prodhuesve, pasi që arriti të avokoj për ndryshimin e dy ligjeve me shumë rëndësi për prodhuesit vendor. Ligje këto që kanë të bëjnë prokurimin publik dhe uljen e normës së akcizës për lëngjet.

## NDRYSHIMI I LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK

Klubi i Prodhuesve së bashku me **STIKK** – Shoqatën për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës, **KIMERK** – Kllasteri i Bizneseve të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës, **KAMA** – Shoqata Kosovare për Marketing të Veshmbathjeve, **Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës** dhe **G7- Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës**, filloi iniciativën për ndryshimin e ligjit për prokurim publik.

Kjo kërkesë erdhi kur shumë prodhues vendorë ishin duke u përballur me vështirësi të shumta shkaku i pandemisë, për këtë arsye u kërkua ndryshimi i ligjit të prokurimit, në mënyrë që **në procedurat e tenderimit për produkte dhe shërbime, të ju jepet përparësi kompanive vendore**. Kjo kërkesë për të ju dhënë përparësi kompanive vendore prodhuese apo shërbyese, u kërkua të bëhet përmes ndryshimit të ligjit për prokurim publik apo përmes një vendimi të veçantë qeveritar.

Ndryshimi i ligjit të prokurimit u bë si pjesë e ligjit për rimëkëmbje, ku ju jepen disa përparësi prodhuesve të produkteve dhe shërbimeve vendore gjatë pandemisë COVID 19. Gjatë vlerësimit të ofertave, ofertuesve vendor do t'i jepet përparësi krahas ofertave të ofertuesve të huaj, në rast se diferenca në mes të këtyre ofertave nuk është më e lartë se 10 pikë. Në rast se kriter për dhënie të kontratës është çmimi më i ulët, atëherë i jepet preferencë ofertuesit vendor në rast se çmimi i po të njëjtës nuk është më i lartë se 15% në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.



## ULJA E NORMËS SË AKCIZËS PËR LËNGJET

Klubi i Prodhuesve të Kosovës e filloi iniciativën për **uljen e normës së akcizës për lëngjet**. Një iniciativë e tillë ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhuesve vendor, e në veçanti të sektorit të lëngjeve, dhe është një ndihmesë shumë e madhe sidomos pas situatës së krijuar në sektorin e prodhimit pas pandemisë COVID19. Pas shqyrtimit të kërkesës së Klubit të Prodhuesve, e cila është parashtruar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave ka propozuar që lëngjet e caktuara, subjekt i shifrës 2202, të cilat kanë normë të akcizës në vlerë prej 0.045€ (katër cent e gjysmë) një litër, **kjo normë e akcizës ulet në 0.005€ (gjysmë centi) për një litër**.

## REZOLUTA E PRODHIMIT

Klubi i Prodhuesve gjatë vitit 2020 ka filluar edhe iniciativën për përkrahjen e Rezolutës së Prodhimit, ku me anë të saj kërkon që industria e prodhimit të shpallet sektor i rëndësishëm nacional. Kjo iniciativë **do të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2021**. Klubi në takimet e para kërkonte nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës që të përkrahë ndërmarrjet prodhuese, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre. Po ashtu, kërkonte nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës që rimëkëmbjen ekonomike të vendit ta bazojnë në fuqizimin e industrisë së prodhimit, si zgjidhjen e vetme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kjo rezolutë kërkon që Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës që **të rrisin buxhetin për sektorin e prodhimit** me qëllim të ofrimit të ndihmës financiare për industrinë e prodhimit. Po ashtu, kjo rezolutë kërkon nga Qeveria e Kosovës do të përkrahë dhe **ndihmojë të gjitha ndërmarrjet prodhuese** në përmbushjen e standardeve të BE-së përkitazi me kualitetin e produkteve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, me qëllim që ndërmarrjeve t'u lehtësohet eksportimi i prodhimeve vendore në BE dhe ndërmarrjet të bëhen konkurruese në tregun e BE-së. Përveç takimit me kryetaren e Kuvendit për iniciativën e rezolutës së prodhimit, Klubi i Prodhuesve u takua edhe me disa nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

## ANKETË MBI NDIKIMIN E COVID-19 NË NDËRMARRJET NË KOSOVË

Ky studim është iniciuar dhe realizuar bashkërisht nga: Klubi i Prodhuesve të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, dhe Këshilli i Investitorëve Evropianë.

Studimi është ndërmarrë për të fituar **një pasqyrë preliminare të ndikimit të pandemisë COVID-19** në ndërmarrjet Kosovare. Studimi është realizuar nga odat në periudhën **1-8 prill 2020 përmes anketimit online**. Duhet pasur parasysh se anketa është realizuar gjatë javës së tretë të kufizimeve si rezultat i pandemisë dhe si rezultat opinionet e paraqitura reflektojnë vetëm situatën fillestare dhe mund të mos reflektojnë drejtë zhvillimet e mëtejshme të shkaktuara nga kriza shëndetësore. Nga rreth **4,000 kontakte online** shkalla e përgjigjes ka qenë 462, që është një **shkallë përgjigjeje prej 11%** e cila konsiderohet **shumë e mirë** në anketimet online.

Sa i përket perceptimit të ndërmarrjeve të anketuara, **95% e tyre e kanë vlerësuar** ndikimin e krizës së shkaktuar nga COVID-19 **si negative (58.6% si shumë negative)**. Rreth ndikimit të COVID-19 në aktivitetin e ndërmarrjeve të anketuara dhe mënyrën se si po veprojnë **83.6% e ndërmarrjeve** shprehen se kriza ka zvogëluar aftësinë e tyre për të punuar, ku **39% janë mbyllur tërësisht, 30.7% punojnë me kapacitet të reduktuar dhe 13.8% me orar të shkurtuar**.

## ANKETË - QASJA NË FINANCA E KOMPANIVE PRODHUESE DHE NDIKIMI I COVID-19

KPK në bashkëpunim me Korporatën Ndërkombëtare Financiare – IFC (anëtar i grupit të Bankës Botërore) kanë zhvilluar këtë anketë me qëllim që të identifikojnë ndikimin e krizës nga COVID-19 tek kompanitë prodhuese, vlerësimin e ndërhyrjeve të mundshme për të mbështetur kompanitë prodhuese si dhe potencialin për zhvillimin e instrumenteve financiare për të rritur qasjen në financa dhe forcuar konkurrueshmërinë e kompanive prodhuese.

Pyetësoni u hartua bashkërisht nga IFC dhe KPK. Anketimi u realizua online dhe është shpërndarë përmes email-ës. Mostra për këtë studim u përcaktua duke përdorur bazën e të dhënave të KPK-së sa i përket kompanive aktive prodhuese, për të kuptuar perceptimin e tyre në lidhje me pozicionin e tyre të biznesit, financat, eksportet, burimet njerëzore, kufizimet e biznesit dhe skemat mbështetëse. **Nga 350 kompani të kontaktuar, 199 pyetësor janë plotësuar me sukses.**

## KODIT TË BIZNESEVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Klubi i Prodhuesve të Kosovës në kuadër të Konventës së Prodhuesve ka bërë edhe nënshkrimin e **Kodit të Bizneseve kundër Korrupsionit.**

Nëpërmjet këtij Kodi, anëtarët e Klubit të Prodhuesve u zotuan se do të zbatojnë standardet më të avancuara të etikës, transparencës dhe të integritetit në aktivitete të tyre biznesore, se do të shmangin me vendosmëri çdo formë të përfshirjes në raste të korrupsionit, ofrimin të dhuratave apo favoreve tjera zyrtarëve publikë apo personave tjerë zyrtarë apo privat që kanë për qëllim sigurimin e privilegjeve apo përfitim të paligjshëm në favor të kompanisë. Kodi kundër korrupsionit ka për qëllim që t'i ndihmojë bizneset të implementojnë aktivitete të drejta, transparente dhe ligjore



## Takimet

### TAKIM ME GERMIN

Klubi i Prodhuesve të Kosovës priti në takim **anëtarët e bordit të organizatës Germin**, me të cilin bashkëbiseduan për projektet dhe aktivitetet në të cilat janë përfshirë këto dy organizata por edhe për bashkëpunimet në të ardhmen. Ata u njoftuan me aktivitetet dhe projektet në të cilat Klubi është i angazhuar por edhe projektet që priten të zhvillohen, ku u theksua fokusi i Klubit të Prodhuesve në projektet që nxisin fuqizimin e sektorit të prodhimit, sidomos në rritjen e kapaciteteve të konkurrueshmërisë dhe ngritjen e kadrove të reja profesionale. Të dy organizatat u zotuan për thellim të bashkëpunimit të mëtutjeshëm, qëllimi i të cilit është rrjetëzimi dhe fuqizimi i anëtarëve të këtyre dy organizatave.



## TAKIM ME MINISTRIN E FINANCAVE DHE TRANSFEREVE, Z.BESNIK BISLIMI

Klubi i Prodhuesve të Kosovës u takua me **Ministrin e Financave dhe Transferëve, z.Besnik Bislimi**, me të cilin biseduan rreth **gjendjes së krijuar nga virusi COVID-19**. Gjatë takimit u diskutuan efektet dhe pasojat që kjo situatë ishte duke shkaktuar në ekonominë e vendit tonë, por edhe për gjetjen e zgjidhjes dhe tejkalimit të kësaj krize. Klubi i Prodhuesve u zotua që sektori i prodhimit do të vazhdoj punën duke respektuar vendimet dhe rregullat nga situata e krijuar, por kërkoi më shumë mbështetje për prodhimin si dhe sigurimin dhe mbrojtjen e së ardhmes së këtij sektorit në Kosovë edhe ashtu shumë të brishtë edhe para kësaj krize. Klubi i Prodhuesve të Kosovës tregoi që e kuptonin që një prej sfidave më të rëndësishme me të cilat po përballej Qeveria e Kosovës është mbajtja nën kontroll e gjendjes pa panik dhe izolimi sa më i shpejtë i virusit COVID-19. Por, gjithashtu treguan që kjo gjendje ishte duke shkaktuar shqetësime serioze për prodhuesit vendas dhe efektet që do të ketë kjo krizë në ekonominë e vendit tonë, prandaj ishte mese e domosdoshme mbështetja e Qeverisë për prodhuesit në ato momente.



## TAKIM I KRYEMINISTRIT ME PRODHUESIT GJATË PANDEMISË

Klubi i Prodhuesve të Kosovës organizoi një vizitë për **kryeministrin në detyrë Albin Kurti dhe ministren në detyrë Rozeta Hajdari** nga Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, tek dy prodhues në komunën e Lipjanit. Kësaj radhe në vizitë ishin tek kompania e prodhimit të letrës së lagur **Happy** dhe tek kompania e përpunimit të drurit **Elnor**. Kryeministri Kurti së bashku me ministren Hajdari, u njoftua nga afër për sfidat që këta prodhues po përballeshin gjatë kësaj kohe dhe shprehen gatishmëri që të jenë më afër prodhuesve gjatë kësaj kohe. Po ashtu edhe prodhuesit vlerësuan vizitën dhe kërkuan që përkrahja e ardhshme e qeverisë të jetë më e fortë dhe kërkuan që zëri i prodhuesve të dëgjohet në marrjen e vendimeve të cilat i prekin ata.



## TAKIMI MES SEKTORIT TË PRODHIMIT DHE SHITJES ME PAKICË

Fuqizimi i mëtejshëm i sektorit të prodhimtarisë krahas zhvillimit të sektorit të shitjes me pakicë, është parakusht për zhvillimin e ekonomisë së vendit, ndërsa bashkëpunimi ndër sektorial jetik për përcaktimin e trajektorës së nivelit të këtij zhvillimi. Në këtë drejtim, Klubi i Prodhuesve të Kosovës në bashkëpunim me Rrjetin e Shitësve me Pakicë organizuan vizita në rrjetet e supermarketeve si VivaFresh dhe Interex ku dhe u takuan me udhëheqësit e kompanive përkatëse. Thellimi i bashkëpunimit, sigurimi i furnizimit gjatë kohës së pandemisë, njohja më e afërt me kërkesat e konsumatorëve dhe bashkërendimi i hapave që mundësojnë zhvillimin e të dy sektorëve, ishin arsytet e organizimit të këtyre takimeve. Prodhuesit u shprehën të kënaqur me takimet ndërsa falënderuan rrjetet për bashkëpunimin e deritanishëm, teksa theksuan nevojën e rritjes së përkrahjes edhe më shumë në të ardhmen.



## KLUBI I PRODHUESVE TAKOI GUVERNATORIN E BQK-SË

Klubi i Prodhuesve të Kosovës u takua me **Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës z.Fehmi Mehmeti**, me të cilin diskutuan për gjendjen e ekonomisë së vendit gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe situatën pas pandemisë. Prodhuesit gjatë takimit kërkuan një **plan të qartë të rimëkëmbjes dhe për mbështetjen e ekonomisë së vendit**, në mënyrë që të rritet likuiditeti por edhe investimet.

Po ashtu gjatë takimit u diskutua që kriza e shkaktuar nga pandemia bëri edhe një herë të qartë që duhet të rishikohet struktura e ekonomisë së vendit, ku prioritet duhet të ketë sektori i prodhimit për rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Guvernatori i BQK-së ju ofrojë përkrahje prodhuesve duke shprehur gatishmërinë që të ju ndihmojë në mënyrë që bashkërisht të ndihmojnë në rimëkëmbjen e ekonomisë dhe tejkalimin e sfidave kryesore e që janë deficieti i lartë tregtarë dhe shkalla e lartë e papunësisë.



## PRODHUESIT DHE TREGTARËT TAKOHEN ME MEPTINIS DHE MFT

Qëndrueshmëria ekonomike e bazuar në fuqizimin e sektorit të prodhimit dhe zgjerimi i njëkohshëm i sektorit të shitjeve me pakicë është garantues për zhvillimin e vendit, andaj gjetja e formave për thellimin e bashkëpunimit në mes të sektorëve është jetike, u tha në takimin e organizuar nga **MEPTINIS dhe Ministria e Financave dhe Transfereve**, me Klubin e Prodhuesve të Kosovës dhe Rrjetin e Shitësve me Pakicë. Anëtarë nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe Rrjeti i Shitësve me Pakicë diskutuan mbi rëndësinë e funksionimit si tërësi të trekëndëshit: **prodhues, shitje me pakicë dhe konsumator.**

Gjatë takimit të dy palët u dakorduan që prodhimi vendor duhet të vazhdojë që të mbështetet, në mënyrë që të arrihet një standard më i lartë në prodhim, por edhe të shtyhen përpara prodhimet Made in Kosova, si brenda ashtu edhe jashtë tregut të vendit. Por, padyshim që u theksua që edhe roli i Qeverisë është esencial në fuqizimin e rolit të prodhimit dhe lehtësimin e tregtisë.



## PRODHUESIT MORËN PËRKRAHJEN E MINISTRIT MUSTAFA PËR RIMËKËMBJEN E SEKTORIT PRODHUES E PËRPUNUES

Klubi i Prodhuesve të Kosovës u takua me Ministrin në detyrë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Besian Mustafa, ku diskutuan për **zhvillimet e përgjithshme në sektorin e bujqësisë në vend**, sfidat e sektorit si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe projektet përkrahëse ndaj këtij sektorit në Kosovë.

Ministri në detyrë Mustafa gjatë këtij takimi i ka njoftoi nga afër disa nga anëtarët e Klubit të Prodhuesve me objektivat dhe prioritetet e MBPZhR-së gjatë kësaj periudhe por edhe për **hartimin e programeve mbështetëse** konkrete të cilat do të ju vijnë në ndihmë prodhuesve nga sektori i bujqësisë, e të cilat kanë për qëllim rimëkëmbjen e këtij sektori.

Z.Mustafa u zotua që do të vazhdoi të jetë pranë fermerëve dhe agropërpunuesve duke i mbështetur që të mos kenë ngecje në sektorin prodhues dhe përpunues.





## KLUBI I PRODHUESVE NË VIZITË TEK EGI GROUP DHE RRJETI I SUPERMAKETEVE ETC

Anëtarët e Klubit të Prodhuesve të Kosovës, vazhduan vizitat tek **Egi Group dhe rrjetin e supermaketeve ETC nga kompania Elkos**. Vizata kishte për qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet prodhuesve dhe shitësve me pakicë, kështu duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Të dy palët gjatë takimit theksuan potencialin e zhvillimit të dy sektorëve, por edhe rritjen e mundshme të bashkëpunimit e cila do të fuqizonte prodhimet vendore si brenda ashtu edhe jashtë tregut të vendit.



## KLUBI I PRODHUESVE TAKIM NË MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Klubi i Prodhuesve të Kosovës u takua me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, z.Vesel Krasniqi, ku diskutuan për **zhvillimet e përgjithshme në ekonominë e vendit**, por edhe për sfidat e sektorit të prodhimit si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe projektet përkrahëse ndaj këtij sektorit në Kosovë.

Gjatë takimit u diskutua rreth kërkesave të cilat u paraqiten nga prodhuesit por edhe rreth planit të mbështetjes së bizneseve nga pasojat e pandemisë. Si prodhuesit, ashtu edhe vetë ministri Krasniqi theksuan nevojën e bashkëpunimit reciprok në tejkalimin e kësaj krize.



## KRYEMINISTRI HOTI TAKON ANËTARËT E BORDIT TË KLUBIT TË PRODHUESVE TË KOSOVËS

Kryeministri Avdullah Hoti, ka pritur në takim disa nga anëtarët e bordit të Klubit të Prodhuesve për të **diskutuar për gjendjen e përgjithshme të ekonomisë së vendit**, e veçanërisht të sektorit të prodhimit, sidomos pas gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19. Gjatë takimit kryeministri Hoti, i njoftoj prodhuesit për hapat që ka ndërmarr qeveria për përkrahjen e sektorit të prodhimit, por edhe të rimëkëmbjes së ekonomisë së vendit. Me këtë rast, kryeministri Hoti shprehi gatishmërinë e Qeverisë për fuqizimin edhe më tej të dialogut ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve që do të lehtësonte mjedisin e bizneseve prodhuese në Kosovë.

Po ashtu edhe prodhuesit, **e theksuan nevojën e bashkëpunimit reciprok** në tejkalimin e kësaj krize, por edhe kërkuar mbështetjen më të madhe duke hartuar programe të veçanta për sektorin e prodhimit, deri në stabilizimin e gjendjes ekonomike. Ata po ashtu kërkuar edhe tejkalimin e ngërçit politik dhe votimin e marrëveshjeve në kuvend për financimin e pakos së rimëkëmbjes.



## KLUBI I PRODHUESVE TAKIM ME MINISTREN BAJRAMI NË MINISTRINË E FINANCAVE

Bordi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës u takua me ministren e Financave znj. Hykmete Bajrami ku diskutuan për zhvillimet e përgjithshme në ekonominë e vendit si dhe **për vështirësitë e sektorit të prodhimit në Kosovë** për shkak të pandemisë COVID-19, por gjithashtu edhe për planet e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike. Në takim, palët shkëmbyen pikëpamjet e tyre sa i përket situatës ekonomike dhe u zotuan që të vazhdojnë dialogun për tema që kontribuojnë në **përmirësimin e kushteve të sektorit të prodhimit dhe rritjes ekonomike të vendit**. Gjatë takimit u diskutua rreth kërkesave të cilat u paraqiten nga prodhuesit por edhe rreth planit të mbështetjes së prodhuesve nga pasojat e pandemisë. Si kërkesë kryesore e prodhuesve ishte që procesi i rimëkëmbjes ekonomike të fokusohet përmes përkrahjes së prodhimit. Largimi i pagesës së TVSH-së për lëndën e parë që prodhohet në Kosovë, rregullimi i sistemit të pagesave ku do të tejkalohen vonesat e shumta, si dhe mbështetja e fushatës Made in Kosova, e cila ka për qëllim kryesor fuqizimin e prodhimeve vendore.



## TAKIMI ME KRYETAREN E KUVENDIT ZNJ.OSMANI

Kryetari i Bordit të Klubit të Prodhuesve, z.Bashkim Osmani së bashku me ekzekutivin e Klubit të Prodhuesve ishin në një takim me Kryetaren e Kuvendit të Kosovës znj. Vjosa Osmani.

Arsyeja e takimit ishte diskutimi mbi **gjendjen e sektorit të prodhimit dhe avokimi** për ndërmarrjen e disa masave të cilat do të ndikonin drejtpërdrejtë në përmirësimin e kësaj gjendje.

Kryetarja Osmani, i falënderoi përfaqësuesit e Klubit të Prodhuesve për vizitën dhe shprehu gatishmërinë që të përkrahë këtë rezolutë por edhe iniciativat tjera kështu duke ju qëndruar prodhuesve gjithnjë pranë.



## TAKIM ME MINISTRIN E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Klubi i Prodhuesve të Kosovës ishte në një takim pune me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë z. Vesel Krasniqi, ku e falënderuan dhe e përkrahën për ftesën e tij publike drejtuar institucioneve publike dhe shtetërore të vendit që t'i mbështesin prodhimet vendore. Ftesë kjo e cila kërkon që në procedurat e tenderimit këto institucione të fusin si kriter edhe prodhimin vendor. Klubi i Prodhuesve e falënderuan Ministrin Krasniqi, dhe deklaruan që një ftesë e tillë tregon edhe një herë përkushtimin e kësaj Ministrie në fuqizimin dhe zhvillimin e produkteve vendore. Por edhe seriozitetin e Ministrin në marrjen për bazë të kërkesave të cilat janë shqyrtuar në takime të shumta me vetë prodhuesit.



### TAKIMI ME GRUPIN PARLAMENTAR TË PDK-SË

Klubi i Prodhuesve, ishin në një takim pune me grupin parlamentar të Partisë Demokratike në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht me deputet z.Bedri Hamza dhe z. Enver Hoxhaj. Gjatë takimit u diskutua mbi **gjendjen e prodhimit në vend dhe për sfidat me të cilat po përballen prodhuesit gjatë kohës së pandemisë**, por edhe kërkesat e menjëhershme të tyre për rimëkëmbje nga kjo gjendje. Klubi i Prodhuesve morri përkrahjen e deputeteve të PDK-së për sa i përket miratimit të rezolutës, dhe njëkohësisht ata u shprehën të gatshëm dhe të hapur për bashkëpunime tjera.



### TAKIM ME MZHR DHE BERZH

Klubi i Prodhuesve të Kosovës së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) mbajtën takimin e radhës për - Thirrjen e bizneseve për regjistrim dhe pjesëmarrje në Akademinë "Know-How".

Qëllimi i takimit ishte diskutimi dhe plani i përbashkët i veprimit në vazhden e takimeve të përbashkëta që po realizohen në mes MZHR-së dhe BERZH-it, në kuadër të akademisë "Know-How", e cila është një platformë informative ku sipërmarrësit mund të **përftojnë këshilla praktike, përfshirë edhe materiale trajnimi apo konsulencë mbi menaxhimin e krizës**, nga ekspertë ndërkombëtarë të industrisë, ku mund t'i bashkohen forumeve të diskutimit me homologë të vendeve të tjera.



### TAKIM ME AMBASADORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Astrit Panxha, drejtori i Klubit të Prodhuesve dhe Sekretari gjeneral Vllaznim Osmani u takuan me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, z.Qemal Minxhozi, ku diskutuan për **gjendjen e tanishme ekonomike të dy vendeve**, por edhe mundësitë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm tregtar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.



### TAKIM ME MINISTRIN E ZHVILLIMIT RAJONAL

Drejtor i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha ishte në takim me Ministrin e Zhvillimit Rajonal z. Enis Kervan, ku prezantoi para ministrit punë e deritanishme të Klubit si dhe aktivitetet e anëtarëve të Klubit të Prodhuesve. Në takim, në të cilin ishte i pranishëm edhe Zëvendës Sekretari i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal Besim Kamberaj, u konsultuan hapat e përbashkët që mund të ndërmerren drejt rritjes së kapaciteteve të ndërmarrjeve prodhuese dhe zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.



### TAKIMI ME SHOQATËN ESNAF PRIZREN

Drejtori i Klubit të Prodhuesve të Kosovës Astrit Panxha, së bashku me disa nga anëtarët e Klubit të Prodhuesve ishin në vizitë tek ESNAF Prizren ku diskutuan për shumë çështje që kanë të bëjnë me prodhimin, e në veçanti për rëndësinë që ka edukimi profesional në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik.



## TAKIME ME PRODHUESIT

Po ashtu gjatë vitit 2020 Klubi i Prodhuesve të Kosovës vizitoi një numër të konsiderueshëm të prodhuesve, që të shoh nga afër prodhimin dhe gjendjen e tyre gjatë kohës së pandemisë COVID 19.



## KLUBI PJESË E GRUPIT PUNUES PËR PËRGATITJEN E PAKETËS SE RIMËKËMBJES EKONOMIKE COVID-19

Qeveria e Kosovës menjëherë pas fillimit të masave kufizuese ka kërkuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve të iniciojë draftimin e pakos për adresim të dëmeve të shkaktuara nga pandemia. Paralelisht me këtë dhe duke ndjekur zhvillimin e aktivitetit ekonomik, është krijuar grupi punues për dizajnimin e pakos së dytë (pakoja e rimëkëmbjes ekonomike).

Pjesë e grupit punues kanë qenë edhe Klubi i Prodhuesve së bashku me Zyrën e Kryeministrit, ministritë relevante ekonomike, Banka Qendrore, Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive, komuniteti i biznesit dhe ekspertë të jashtëm. Nga inputet e këtij grupi është dizajnuar pakoja me ndikim të përgjithshëm në ekonomi në vlerën e 1.26 miliardë eurove, me periudhë plasimi në ekonomi prej 24 muajsh kurse me shtrirje të kostos në pesë vitet në vijim.

## KLUBI PJESË KËSHILLI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE INVESTIME

Klubi i Prodhuesve përgjatë vitit 2020 ishte edhe pjesë e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik i cili shërben si organ harmonizues midis institucioneve shtetërore dhe sektorit privat, duke adresuar dhe eliminuar barrierat e të bërit biznes. Ky këshill përbëhet nga ekspertë në fushën e ligjit dhe ekonomisë i cili ndihmon për hulumtimin e indikatorve që mund kenë sugjerimet nga anëtarët e KKEI.

## Anëtarët e Nderit në Klubin e Prodhuesve të Kosovës

Bordi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës pati nderin dhe kënaqësinë që të shpall dy anëtarë nderi për vitin 2020. Ky titull i takoi z. Muhamet Mustafa dhe znj. Eriola Bibolli. Anëtarët e Nderit në Klubin e Prodhuesve janë figura të shquara që me punën e tyre shumëvjeçare kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës si dhe kanë arritur të krijojnë reputacion të mirë në komunitet.

z. Mustafa me përkushtimin dhe punën e tij ka dhënë një kontribut tejet të çmuar në përmirësimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, si një ndër intelektualët më të shquar të Kosovës, që krahas karrierës së studiuesit dhe të profesorit universitar në fushën e ekonomisë, ka edhe një karrierë të bujshme publike dhe politike si udhëheqës i institucioneve të rëndësishme ekonomike të Kosovës.

Ndërsa, Znj. Bibolli si Kryeshefe Ekzekutive e ProCredit Bank, po ashtu ka dhënë një kontribut të çmuar në fuqizimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, bankë e cila me vite ka përkrahur sektorin e prodhimit, kështu duke ju mundësuar operimin e prodhuesve por edhe mundësinë që të njëjtit të krijojnë vende të punës dhe të japin kontribut thelbësor në ekonominë në të cilat operojnë.



## Mirënjohje

### MIRËNJOHJEJE NGA KOMUNA E VUSHTRISË

Në Ditën e Çlirimit të Vushtrisë për angazhimin e madh të Klubit të Prodhuesve që të ndihmojë familjet në nevojë gjatë pandemisë së koronavirusit COVID-19. Klubi i Prodhuesve u nderua me mirënjohje nga Kuvendi Komunal i Vushtrisë në një ceremoni të udhëhequr nga kryetari Xhafer Tahiri.



### MIRËNJOHJEJE NGA KOMUNA E VITISË

Kjo mirënjohje i është dhënë Klubit të Prodhuesve për organizimin e fushatës Besa për Kosovën: Diaspora në ndihmë të atdheut gjatë COVID-19. Mirënjohja u nda nga Kryetari i Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti.

Besa për Kosovën ishte fushatë humanitare e cila ndihmoi familjet të cilat ishin në kushte të vështira ekonomike gjatë pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, por njëkohësisht mbështeti prodhuesit vendor.



## Ekipi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës



**Astrit Panxha**  
Drejtor Ekzekutiv



**Tanita Zhubi**  
Menaxhere për PR & Komunikim



**Vllaznim Osmani**  
Sekretar Gjeneral



**Besart Zhuja**  
Analist i Politikave



**Ylberina Hysaj Arifi**  
Koordinatore e Zyrës



**Vesa Shehu Hoxha**  
Koordinatore e Projekteve

“

Ne veprojmë me përkushtim në implementim të strategjisë, realizim të aktiviteteve dhe qëllimeve të Klubit - për të ndihmuar anëtarët tonë të zhvillohen dhe rriten.



